

ISBN 978-9989-857-13-3

Titulli: Raport Alternativ për gjendjen e të dejtave të fëmijëve në Republikën e Maqedonisë - vështruar nga ana e fëmijëve

Botues: Ambasada e Parë e fëmijëve në botë Megjashi - Republika e Maqedonisë

Drejtor egzekutiv dhe themelues: M-r Dragi Zmijanac

Autorë: Ajan kajçagoski, Matkova Gordana, Georgiev Nenad, Metodija Jovanov, Despina Apostolska, Zorica Nikoloska, Ėvgenija Gjorgjioska, Nevenka Ridova, Gjoreska Aleksandra, Petar Josifov, Marko Bozhinovski, Olja Stojkovska, Mario Petkovski, Marko Trajkoviq, Tamara Gjorgjevska, Elena Dimitrievska, Natali Markoska, Sofija Maņeva, Vaska Bojaxhi, Gjorgji Tuparov, Liridona veliu, Edmond Abdeu, Fatbarda Hasani, Jordanoski Dijana, Hristoska Meri, Koneska Valerija, Stefanija Zmijanac, Dragana Stankoviq, Jelisaveta Stankoviq, Fikret Veseli, Nadezhda Dameska, David Stojkovski, Vasil Karakulev, Elena Lazarova, Lubica Trajkova, fatime Ajrullovska, Mila Damjanovska, Biljana Ristevska.

Mentor: Gordana Pirkovska Zmijanac

Grupi projektues: Tatjana Janevska,
Katerina Koneska, Svetlana Mulkeen

Përkthimi dhe lektorimi: Florim
Ismailovski

Dizajnimi i kopertinës: Besnik Selmani

Pregaditje grafike dhe shtypi: Jugoreklam

Tirazhi: 200 copë

Adresa e Botuesit:

Ambasada e Parë e Fëmijëve në botë
Megjashi - Maqedoni

rr. Kosta Novakoviq nr. 22

1000 Shkup, Maqedoni

Tel. +389 2 2463 316, faksi: +389 2 2465-900

Telefoni për të rinj dhe fëmijë: 0800 1 2222

E-mail: info@childrensembassy.org.mk
www.childrensembassy.org.mk

Të drejtat e fëmijëve në Maqedoni nga ana e fëmijëve

SHKUP, NËNTOR 2009

PËRMBAJTJA

Parathënie	4
I. Hyrje.....	7
II. Njoftimi i fëmijëve me të drejtat e tyre dhe Konventën	9
III. Pjesëmarrja e fëmijëve në sjelljen e vendimeve për çështje në interesin e tyre	12
1. Rrespektimi i mendimit të fëmiut në familje.....	12
2. Rrespektimi i mendimit të fëmiut në shkollë	12
3. Parlamenti i fëmijëve dhe forma tjera të shoqërimit të fëmijëve	13
4. A janë të fuqishëm fëmijët që të bëjnë ndryshime pozitive?	14
IV. Dhuna mbi fëmijët.....	14
1. FAMILJA	14
2. SHKOLLA	15
V. Diskriminimi.....	17
VI. Institucione, organizata dhe individë të cilët kujdesen për të drejtat e fëmijëve	19
VII. Kualiteti i jetës	22
VIII. Vërejtje të veçanta	25
Fëmijë të shkyçur(përfshijtur) nga shkolla.....	25
Arsimimi kualitativ.....	25
Fëmijë me nevoja të veçanta	27
Rrespektimi i të drejtave të fëmijëve.....	27
IX. Konkluzione	28
X. Rekomandimet tona.....	30
XI. Rekomandime nga fëmijë të tjerë	31
ARSIMI	31
SHËNDETËSIA	33
DISKRIMINIMI.....	33
EDUKIM	33
MEDIUMET	33
TË TJERA	33

Parathënie

Për ata të cilët dëshirojnë të dijnë diç më tepër se si u krijua ky raport dhe pse është i pregaditur i njejt.

Para jush është raporti Alternativ ose i a.q. Raport në hije i pregaditur nga ana e fëmijëve të kyçur në projektin Krijimi i kulturës së pjesëmarrjes fëmijërore. Kjo është hera e parë në Republikën e Maqedonisë fëmijët të pregadisnin raport të tyre dhe të njejtin ta përfaqësojnë para Komitetit për të drejtat e fëmiut praën Organizatës së Kombeve të bashkuara (OKB). Shumë pak shtete deri tani në botë kanë qenë të prezentuara para Komitetit me raport alternativ për gjendjen e të drejtave të fëmiut të pregaditur nga fëmijët.

Konventa për të drejtat e fëmiut u miratua nga Asambleja e përgjithshme e OKB-së në vitin 1989. Të drejtat e përmbytura në këtë Konventë i definojnë parimet univerzale dhe normat për statusin e fëmiut. Republika e Maqedonisë u bashkua drejt Konventës në Nëntor të vitit 1993. Raporti i parë për gjendjen me të drejtat e fëmijëve, shteti shteti nënshkruet patjetër duhet që ta dërgoje 2 vite pas ratifikimit të Konventës. Më tej, raporte kërkohen çdo 5 vite, me mundësi për raporte shtesë në ndërmjet-periodhë, nëse kjo është e nevojshme. Në vitin 2007, Republika e Maqedonisë e dorëzoi raportin e dytë periodik për Konventën. Të gjitha raportet i shqyrton Komiteti për të drejtat e fëmiut praën OKB, i cili takohet disa herë në vit në Gjenevë. Kur do ti fitojë Komiteti raportet shtetërore, më tej kërkon informata të shkruara nga organizatat joqeveritare ose ndërqeveritare. Ajo që është veçanërisht e rëndësishme është se Komiteti në veçanti vlerëson nëse edhe fëmijët japin raport të tyre dhe marrin pjesë në mbledhjet (sesionet në të cilat bisedohet për raportet dhe kërkohen përgjigje nga an e qeverisë në pyetje të caktuara). Respektimi i mendimit të fëmijëve dhe pjesëmarrja e fëmijëve në çështje që janë në interesin e tyre është e rëndësishë së veçantë për secilin shtet i cili synon të bëhet demokratik dhe sipas mënyrës që u përshtatet fëmijëve. Pjesëmarrja e fëmijëve u

mundëson fëmijëve dhe të rinjve të ndëgjohen, në mënyrë aktive të krijojnë dhe të paraqesin ndryshime pozitive në bashkësi.

për atë qëllim, përveç organizatave joqeveritare dhe ndërqeveritare, poashtu edhe fëmijët fillojnë që të bashkohen dhe të pregaditin raporte të tyre me të cilat duhet që ti ndihmojnë Komitetit për të drejtat e fëmijut që i njejtë të fitojë një pamje të qartë për atë se a e tregojnë raportet shtetërore situatën reale të fëmijëve, të vendos prioritetet dhe ti përcaktojë pyetjet kyçe deri te qeveritë.

Gjatë kohës së takimit preliminary, Komiteti për të drejtat e fëmijut i merr parasysht të gjitha informatat e rëndësishme të fituara nga fëmijët dhe organizatat joqeveritare dhe pregadit një listë me pyetje e cila u dorëzohet qeverive. Nga qeveritë kërkohet që të përgjigjen në këto pyetje me shkrim. Më tej, për seancën plenare, Komiteti i thërret përfaqësuesit e qeverisë të përgjigjen në disa pyetje.

Me qëllim që në mënyrë adekuate tu përgjigjet kërkesave të Komitetit për të drejtat e fëmijut, në Vjeshtën e vitit 2008 Ambasada e Parë e fëmijëve në botë Megjashi filloi me realizimin e projektit Krijimi i kulturës së pjesëmarrjes fëmijërore. Aktivitetet ishin të drejtuar ndaj kyçjes më aktive të fëmijëve dhe të rinjve në procesin e monitorimit të të drejtave të fëmijëve, e në vëçanti për shkak të asaj se **Qeveria e Republikës së Maqedonisë ende nuk e ka miratuar pjesëmarrjen e fëmijëve si politikë e rregullt në sjelljen e vendimeve nga lëmia e të drejtave fëmijërore. Mungesa e mekanizmave të ndëgjimit të zërit të fëmijëve në nivel nacional është shkak pse zëri i tyre nuk ndëgjohej, pse fëmijët në mënyrë aktive nuk janë të kyçur në krijimin dhe ndërtimin e ndryshimeve.** Pregaditja e raportit Alternativ paraqet një hap të rëndësishëm ndaj realizimit të këtij qëllimi. Mu për atë krijuam një rrjet nga 7 organizata joqeveritare, të cilat formuan grupe prej 10 deri 15 fëmijë, në moshë prej 10 deri 18 vitesh, të cilët poashtu ishin të kyçur në procesin e hulumtimit të të drejtave të fëmijëve në Maqedoni, të cilën fëmijët e realizuan në Qershor të vitit 2009. Më tepër informata për hulumtimin shiko në:

<http://ëëë.childrensembassy.org.mk/?ItemID=DED8E0F2EA1A2B4DB67BFA37D65147EB>

Që të pregadisim një raport gjithpërfshirës, ambasada e Fëmijëve Megjashi u bashkua edhe me 6 organizata tjera joqeveritare: Shoqata humanitare Nëna nga Kumanova; Qendra për bashkëpunim ballkanik Loja nga tetova, Këshilli për parandalim të delikuencës së të miturve, Organizata e grave Antiko nga Kërçova, Qendra për iniciativa qytetare nga Prilepi, qendra për zhvillim të qëndrueshëm Porta nga Strumica. Kishim tre trajnime, 3 punëtori, shumë shoqërim dhe shumë punë, ashtu që si rezultat i tërë procesit në fund doli edhe ky raport.

I faleminderojmë Delegacionit të Unionit Evropian dhe UNICEF-it për mbështetjen në procesin e hartimit të këtyre raporteve.

Gordana Pirkovska Zmijanac
Program menaxhere dhe themeluese
Ambasada e parë e fëmijëve në botë Megjashi

I. Hyrje

Raporti në hije, i pregaditur nga ana e fëmijëve ka për qëllim që të prezentojë të dhëna të cilat i tangojnë një numër sa më të madh të të drejtave fëmijërore nga Konventa për të drejtat e fëmiut, e gjithë kjo me qëllim që të paraqesë një pamje të qartë të shkallës së rrespektimit të tyre në vend.

Ky raport në hije epregaditëm një grup i fëmijëve dhe të rinjve, anëtarë të shtatë OJQ-ve edhe ate: Inicijativa qytetare e grave “Antiko” - Kërçovë, Organizata humanitare “Nëna” - Kumanovë, Këshilli për parandalim nga delikuenca e të miturve - Kavadar, Qendra për zhvillim të qëndrueshëm “Porta” - Strumicë, Qendra për bashkëpunim ballkanik “Loja”- tetovë, Qendra për inicijativa qytetare - Prilep, ambasada e Parë e fëmijëve në botë “Megjashi”.

Grupin e përbëjnë 62 fëmijë nga shtatë qytete dhe po nga aq organizata qytetare. në mes të anëtarëve të grupit ka fëmijë nga shkollat fillore dhe të mesme, nga grupe të ndryshme etnike, fëmijë me hendikep dhe fëmijë të cilët nuk shkojnë në shkollë.

Hulumtimi i bërë me fëmijë në moshë prej 10 deri 18 vjeçare me ndihmën e pyetësorit anketues, i cili është pregaditur nga ana e fëmijëve. Anketimi është bërë në 41 shkolla fillore dhe në 24 shkolla të mesme, në 16 komuna dhe 7 qytete ndërmjet të cilëve janë : Shkupi (10), Strumica, Kërçova, Kavadari, Tetova, Prilepi, Kumanova.

Anketimi¹ është i bërë mbi 2234 nxënës gjatë muajit Qershor të vitit 2009. Sipas përkatësisë etnike të nxënësve të anketuar 1282 (57.4 %) janë Maqedonas, 659 (29.5%)

¹<http://www.childrensembassy.org.mk/WBStorage/Files/istrazuvanje%20za%20privata%20na%20decata%20vo%20skolite%202009.pdf>
<http://www.childrensembassy.org.mk/WBStorage/Files/Percepcija%20na%20pravata,%20diskriminacija%20i%20nasilstvo%20vrz%20decata.pdf>

janë Shqiptarë, 74 (3.3%) janë Romë, 44 (2%) janë Serb, 33 (1.5%) janë Boshnjak, 31 (1.4%) janë Turq, 4 (0.2%) janë Vllehë dhe të tjerë janë 19 (0.9%). Një pjesë e të anketuarve përkatësisht 88 (3.9%) kanë refuzuar që të përgjigjen në pyetjen për përkatësinë etnike.

Sipas përbërjes gjinore të të anketuarve, meshkuj janë 1034 (46.3%), ndërsa 1078 (48.3%) janë femra. 122 (5.5%) e të anketuarve kanë refuzuar që të përgjigjen në pyetjen e parashtruar.

Në këtë raport i shqyrtuam rezultatet sipas gjinisë, moshës dhe qytetit.

Në kuadër të projektit “Krijimin e kulturës së pjesëmarrjes fëmijërore” u organizuan tre trajnime për të drejtat e fëmijëve, punëtori dhe kampanjë.

Dy nga trajnimet ishin në temën “ Të drejtat e fëmijëve dhe monitorimi i të drejtave fëmijërore”, ndërsa trajnimi i tretë ishte në temën “Fëmijët në procesin e pregaditjes së raportit në hije dhe raportim në lidhje me gjendjen e të drejtave fëmijërore”.

Në punëtori i përpunuam këta tema dhe e pregaditnim raportin. Mes tjerash merrnim pjesë në kampanjën “Arsim për të gjithë”.

Përveç asaj se nëpërmjet të shoqërimit dhe bashkëpunimit i përpunuam temat e lartpërmendura, ne fëmijët si pjesëmarrës kishim mundësinë që mu nëpërmjet të këtij projekti të ndikojmë në krijimin e ndryshimeve pozitive në komunitetin tonë. Me këta të dhëna ne dhamë në dukje të gjendjes së të drejtave të fëmijëve në Maqedoni, e njëherit ofruam edhe rekomandime të cilat konsiderojmë se do të kontribuojnë për përmirësimin e tyre në të ardhmen.

Raporti në hije është pjesë e projektit “Krijimin e kulturës së pjesëmarrjes fëmijërore” finansuar nga ambasada e Parë në botë “Megjashi”.

II. Njoftimi i fëmijëve me të drejtat e tyre dhe Konventën

Njëra nga obligimet themelore të shteteve anëtare që e kanë ratifikuar Konventën për të drejtat e fëmijut është që në mënyrë më të gjerë, aktive dhe përkatëse ti njoftojnë njerëzit (të rriturit dhe fëmijët) për përmbajtjen e saj (të drejtat e fëmijut). Mu për atë dhe disa pyetje tjera nga anketa jonë kishin të bënin me atë se sa fëmijët janë të njoftuara me të drejtat e tyre (si edhe me egzistimin e Konventës) dhe prej nga i kanë marrë informatat.

Pyetja "Cilat të drejta të fëmijut i ke të njohura?" pothuajse 73% nga fëmijët e kanë lënë të paplotësuar, që në fakt dëshmon fakti se pjesa më e madhe e fëmijëve në Maqedoni aspak nuk dijnë për të drejtat e tyre. 27% nga fëmijët të cilat janë përgjigjur në pyetjen i kanë përmendur këta të drejta:

1.	E drejta e shkollimit në gjyhën amëtare	43.0%
2.	E drejta në mendimin e lirë, lirinë e shprehjes, besimit	21.3%
3.	E drejta e mbijetesës dhe zhvillimit në paqe dhe liri	19.7%
4.	E drejta në dashuri, mbrojtje nga keqtrajtimi dhe malltretimi	9.1%
5.	Përgjigje joadekuate	6.0%
6.	E drejta që të jetë i rrespektuar dhe ti rrespektojë të tjerët	4.9%
7.	E drejta në lojë, kohë të lirë dhe relaksim	4.1%
8.	E drejta në shtëpi, prindër/familje	4.1%
9.	E drejta në mbrojtje shëndetësore	2.9%
10.	Të tjera	2.6%
11.	Privatësi	2.6%
12.	E drejta në identitet	2.1%
13.	E drejta në shoqërim të lirë	1.9%

14.	E drejta e barazisë (pa diskriminim)	1.3%
15.	Liria e zgjedhjes	1.2%
16.	E drejta e qasjes deri te informatat përkatëse	0.3%

Konsiderojmë se mosnjohja e së drejtës së barazisë nga ana e fëmijëve paraqet një problem serioz, pasiqë bëhet fjalë për të drejtë të karakterit esencial dhe e drejtë e cila është karakteristike për secilin shtet demokratik.

Në pyetjen “Sipas jush të drejtat e fëmiut i inkuadron edhe obligimet e tij?”, 82.5% janë përgjigjur pozitivisht. Në pyetjen “Çka sipas jush paraqet përgjegjësia e fëmiut?” të anketuarit janë përgjigjur se përgjegjësia është:

1.	Që ti kryej obligimet personale	63.9%
2.	Të sillen me rrespekt ndaj të tjerëve	61.8%
3.	Ti rrespektojë të drejtat e të tjerëve	46.8%
4.	Të përpiqet rreth rrespektimit të të drejtave të të tjerëve	20.2%
5.	Të tjera	6.4%
6.	Përgjigje joadekuate	6.4%
7.	Të mësojë dhe ti kryejë obligimet në shkollë	1.0%
8.	Ti rrespektojë të rriturit (prindërit)	0.6%

Kjo e dhënë na flet për atë se rrespektimi it ë rriturve dhe prindërve është e rëndësishë më të vogël për fëmijët.

Sipas neve, që të ndryshohet situata e këtyllë është e patjetërsueshme që familja të funksionojë në mënyrë më demokratike, përkatësisht më tepër të rrespektohet dhe të merret parasysh mendimi i fëmiut gjatë sjelljes së vendimeve për familjen, me çka mes tjerash do të krijohet një raport miqësor ndërmjet prindërve dhe fëmijëve e me atë edhe më tepër do të rrespektohet.

Në pyetjen “Prej nga keni fituar informata për të drejtat e fëmijut?” fëmijët i kanë dhënë përgjigjet vijuese:

1.	Shkollat	68.9%
2.	Televizioni	46.5%
3.	Në Shtëpi	39.1%
4.	Internet	28.9%
5.	Gazeta/revista	25.6%
6.	Të afërmit/miqtë	18.8%
7.	Organizata joqeveritare	10.2%
8.	Radio	8.0%
9.	Të tjera	5.2%
10.	Pa përgjigje	3.1%
11.	Prindërit	0.1%

Sipas mendimit tonë, organizatat joqeveritare duhet që të bëjnë regrutim të anëtarëve të rinj (të jenë të shpërndarë ndërmjet fëmijëve) dhe tu përkushtojnë vëmendje më të madhe të drejtave të fëmijut dhe implementimit të tyre në shtetin tonë. Poashtu këta të dhëna na flasin për atë se edhe vetë prindërit nuk janë të vetëdijshëm, përkatësisht nuk i njohin të drejtat e fëmijëve.

Në pyetjen “A keni ndëgjuar për Konventën për të drejtat e fëmijut?” 53% nga fëmijët janë përgjigjur me “PO” ndërsa 38.5% me “JO”. Nëpërmjet të burimeve të njehta me të cilat fëmijët njoftohen me të drejtat e tyre, ata kanë ndëgjuar edhe për Konventën.

Me qëllim që të zvoglohet përqindja e madhe e fëmijëve të cilët nuk janë të njoftuar me të drejtat e tyre personale dhe Konventën, rekomandojmë mbajtjen e tribunave, punëtorive, seminareve si edhe hartimi i një dokumenti edukativ si dhe materiale edukative (postere, fletushka) që do të ndahet kryesisht nëpër shkollat.

III. Pjesëmarrja e fëmijëve në sjelljen e vendimeve për çështje në interesin e tyre

Duke e rrespektuar mendimin e fëmijëve dhe pjesëmarrjen e fëmijëve në sjelljen e vendimeve të cilët u përkasin atyre, nuk janë në dobi vetëm për fëmijët, por janë në dobi edhe për tërë shoqërinë. Kjo është njëra nga mënyrat për njohjen me problemet e tyre të vërteta, por edhe mënyrë për zgjidhjen e tyre efikase.

1. Rrespektimi i mendimit të fëmijut në familje

Pjesa më e madhe e fëmijëve konsiderojnë se prindërit e tyre nuk ua imponojnë qëndrimet e tyre dhe e rrespektojnë mendimin e tyre në lidhje me mënyrën e veshjes së tyre, ushqimit, shëtitjes, shoqërimit, mësimin, besimet personale dhe lojën.

Nuk duhet të lihen pas dore edhe të dhënat se ndaj 24% nga fëmijët, prindërit e tyre kanë ndikim ndaj besimeve të tyre personale, ndërsa ndaj 22% në mënyrën e shfrytëzimit të kohës së lirë.

Por duke pasur parasysh atë se fëmijët nuk janë të pjekur plotësisht psikikisht dhe fizikisht, ndonjëherë ndikimet e këtilla nga ana e prindërve mund të jenë në dobinë e tyre. Mirëpo kjo nuk është e arsyeshme nëse qëndrimet e këtilla të imponuara ndikojnë negativisht ndaj fëmijut.

2. Rrespektimi i mendimit të fëmijut në shkollë

Mes tjerash në anketën tonë i pyetëm fëmijët se sa rrespektohet mendimi i tyre nga ana e profesorëve. Me “shumë shpesh” u përgjigjën 40%, ndërsa me “rrallë” 38% dhe me “asnjëherë” 7%. Nga kjo mundemi që të konkludojmë se mendimi i fëmijut nuk rrespektohet mjaft, e as që merret parasysh nga ana e profesorëve.

Bëhet fjalë për thyerjen e të drejtës së fëmijut e cila mund të ketë ndikim negative ndaj zhvillimit të mëtutjeshëm të nxënësit (për shembull mundet që të paraqitet friga nga shprehja e mendimit personal). Përshkak të kësaj është e nevojshme njohja më e mirë e profesorëve dhe ngritja e vetëdijes së tyre për domethënien e kësaj të drejte.

Pjesa më e madhe e fëmijëve (65%) janë të njohur më egzistimin e Kodeksit shkollor (rregullores) të sjelljes, por vetëm pak nga to (31%) kanë qenë të kyçur në sjelljen e tij dhe janë të njoftuar më mirë me përmbajtjen e tij.

3. Parlamenti i fëmijëve dhe forma tjera të shoqërimit të fëmijëve

Pjesa më e madhe e fëmijëve të anketuar nuk janë të njoftuar me egzistimin e parlamentit fëmijëror, organizatës, klubit debatues ose formave tjera të shoqërimit në mjedisin e tyre, që e pamundëson kyçjen e tyre në të njejtat.

Në pyetjen se “A egziston në mjedisin tënd parlamenti i fëmijëve, organizatë, klub debatues ose forma tjera të shoqërimit?”, i fituam përgjigjet si vijojnë:

Po	20%
Jo	33%
Nuk e di	47%

Më të njoftuar me egzistimin e këtyre formave të shoqërimit janë fëmijët nga Kavadari (34%) dhe Strumica (50%) ku numri i atyre që janë përgjigjur pozitivisht në këtë pyetje është dukshëm më i madh në krahasim me qytetet tjera.

Prej atyre që kanë njohuri për egzistimin e parlamentit fëmijëror 16% konsiderojnë se kontribuon në përmirësimin e të drejtave të fëmijëve dhe shprehjen e mendimit fëmijëror, ndërsa 2.5% se nuk kontribuon.

Me qëllim të njoftimit më të mirë me parlamentin fëmijëror dhe punën e tij rekomandojmë promovimin e të njejtit, në veçanti nëpër shkolla.

4. A janë të fuqishëm fëmijët që të bëjnë ndryshime pozitive?

Sipas të dhënave nga anketa 76% nga fëmijët konsiderojnë se janë të fuqishëm që të bëjnë ndryshime pozitive për çështjet që janë në interes të tyre.

Kjo është edhe një shkak më shumë që fëmijët në mënyrë direkte të inkuadrohen në sjelljen e vendimeve që u dedikohen atyre.

IV. Dhuna mbi fëmijët

Sipas rezultateve nga anketa pyetjet për dhunën mbi fëmijët i klasifikuam në kuadër të familjes, shkollës, rrugës dhe ndërmjet shokëve dhe bashkmoshatarëve.

1. FAMILJA

Në familjet e 64% të të anketuarve nuk ka dhunë, ndërsa në 21% nga fëmijët janë shprehur se ka dhunë, nga të cilët 2.3% janë përgjigjur se ajo ndodh për çdo ditë.

Dhunë e përditshme sipas qyteteve	Përqindja
Tetovë	0,9%
Kumanovë	5,4%

Dhunë e përditshme sipas moshës	Përqindja
Viti i parë në shkollë të mesme	5,2%
Klasa e shtatë	1,1%

„A të ka ndodhur që ti personalisht të rrahësh ndonjë anëtarë të familjes tënde?”

Ti personalisht të rrahësh ndonjë anëtarë nga familja yte?	Përqindja
Femra	18%
Meshkuj	14%

Në lidhje me dhunën psikike kategoritë më të shprehura janë fyerja (30%) dhe përqeshje (18%). Kjo është më e dukshme tek nxënësit e vitit të tretë (45% fyerje; 24% përqeshje). Si duket kjo është ashtu përshkak të asaj se bëhet fjalë për fëmijë më të rritur të cilët fizikisht dhe mentalisht janë më të zhvilluar dhe mbi të cilët prindërit nuk mund të aplikojnë forcë fizike.

Përfaqësim të ngjajshëm potencial ka edhe në situatën e kundërt kur fëmijët personalisht fyejnë ose përqeshin ndonjë anëtarë të familjes.

Sipas të dhënave të fituara në kuadër të familjes thyerja e të drejtave të fëmiut më së shpeshti bëhet nga ana e vëllaut/motrës, ndërsa më së shumti rrespektohen nga gjyshja/gjyshi.

2. SHKOLLA

Në pyetjen “A ka në shkollën e juaj dhunë?” - 56% nga fëmijët (përfaqësim të njëjtë në përqindje të meshkujve dhe femrave) kanë konfirmuar se në shkollën e tyre ka dhunë, ndërsa 14% nga rastet ajo ndodh për çdo ditë. Nëpër shkollat e mesme dhuna është për 6% më e përfaqësuar sesa në shkollat fillore.

Si formë më e përfaqësuar të dhunës ndërmjet profesorit -fëmiut janë: thirrja me emra fyes dhe nofka, ofendimi, përqeshje përshkak të prejardhjes etnike dhe ushtrimin e dhunës fizike.

Në pyetjen: “ A nje ndonjë fëmijë të cilin profesori/profesoresha e ka rrahur?” pozitivisht janë përgjigjur 57% nga të anketuarit, që në fakt është më e lartë se përqindja e fëmijëve të cilët në mënyrë direkte kanë pranuar se kanë qenë të rrahur nga profesori (14.5%).

Lloji i dhunës	Përqindja
Shuplakë	63%
Shkop	34%
Fjalë vul;gare	29%
Shkumës	24%
Shqelm	15%

Sipas nesh profesorët e konsiderojnë dhunën fizike si masë pedagogjike efikase, dhe mu për atë edhe e aplikojnë dhe konsiderojnë se do të mund të tolerohet.

Në pyetjet: “A je i informuar për raste të dhunës së nxënësit ndaj profesorit/profesoreshës?” dhe “Në cilën mënyrë nxënësi ka sulmuar profesorin/profesoreshën?” 35% nga të anketuarit janë përgjigjur me “po” në këta forma: me fjalë vullgare 52%, me shuplakë 29%, me shkumës 18%, me shqelm dhe shkop 17%.

Vajzat dhe djemtë shfrytëzojnë forma të ndryshme të dhunës, përkatësisht te femrat më e pranishme është dhuna psikike me një dallim prej 26%, në lidhje më meshkujt, ndërsa meshkujt më së tepërmi e përdorin dhunën fizike me një dallim prej 26% në krahasim me femrat.

Ndërmjet formave të dhunës të cilat egzistojnë në mjediset shkollore llogaritet edhe shqetsimi seksual nga të cilët 9% janë përgjigjur pozitivisht. Konsiderojmë se ky numër është më i madh, pasiqë pjesa më e madhe e fëmijëve nuk dijnë se çka

nënkuptohet me termin shqetësim seksual (si duket përshkak se nëpër shkollat nuk egziston edukimi seksual), ndërsa një pjesë e tyre turperohen që ta pranojnë ate.

Rastet e shumta të dhunës në shkollë ngelin të padukshme, pasi që fëmijët turpërohen që të flasin për këto probleme. Fëmijët duhet që të inkurajohen që të flasin për këta probleme, pasi që heshtja e fëmijëve e ngadalson zgjidhjen e problemeve.

V. Diskriminimi

Anketa tregon se 39% nga meshkujt dhe 43% nga femrat ndonjëherë në ndonjë situatë janë ndjerë të diskriminuara (është bërë ndonjë e padrejtë mbi ta).

Konsiderojmë se njëra nga shkaqet e mundshme për rezultatet e këtilla është e ndërlidhur me atë që e drejta e barazisë (pa diskriminim) është njëra nga të drejtat më pak të njohura (2%).

Përshkak të cilit shkak je ndjejt i/e diskriminuar?	
Mosha	44%
Gjuha	19%
Përkatsia etnike	17%
Gjinia	16%
Religjioni	15%
Raca	9%
Të tjera	36,65%

Diskriminim më të madh në bazë të moshës ka në qytetet Kavadar (60%), ndërsa më së paku në tetovë dhe Kumanovë (40%). Secili nxënës/e i/e dytë nga klasa e 7-të ndjehet i diskriminuar përshkak të moshës, ndërsa përqindja më e vogël e të

diskriminuarve është tek ata të klasës së tetë - secili nxënës/nxënëse, që aspak nuk është numër i vogël.

Gjuha si shkak për diskriminim është më e pranishme te meshkujt - dy herë më tepër sesa te femrat. Në Kavadar është më e vogël përqindja e diskriminimit sipas gjuhës (6%), ndërsa më e madhe në Tetovë (29%). Lloj të këtillë të diskriminimit më së shpeshti ka në klasën e gjashtë (28%), ndërsa më pak ka në vitin e tretë nëpër shkollat e mesme (13%).

Diskriminimi përshkak të prejardhjes etnike është më i pranishëm në qytetet tetovë (31) dhe Kërçovë (32%), poashtu edhe diskriminimi sipas gjuhës, si duket përshkak të asaj se personat që u takojnë etniteteve të ndryshme flasin ndryshe nga të tjerët (në gjuhë të ndryshme). Meshkujt ndjehen më të diskriminuar (22%) sesa femrat (12%). Diskriminim më të madh sipas kësaj baze ka në vitin e parë nëpër shkollat e mesme (23%), ndërsa më së paku në vitin e tretë të shkollave të mesme (10%).

Femrat janë më të diskriminuara në bazë të gjinisë sesa meshkujt (dallim prej 8%). Ky lloj i diskriminimit, si edhe dy shembujt e mëparshëm është më i pranishëm në dy qytetet Tetovë (20%) dhe Kërçova (21%), dhe më së shumti ndodh ndërmjet nxënësve nga viti i parë në shkollat të mesme (23%), ndërsa më së paku në vitin e tretë në shkollat e mesme (11%).

Diskriminimi në bazë të besimit fetar, poashtu, është e pranishme tek fëmijët, më së tepërmi në klasën e pestë (31%), ndërsa më së paku në vitin e tretë në shkollat të mesme (5,7%). më së shpeshti ndodh në qytetet e Tetovës (25%) dhe Kërçovës(32%).

Raca si shkak për diskriminim është më e pranishme tek meshkujt (14%), sesa tek femrat (5%), më së tepërmi në klasën e pestë (17%), si dhe diskriminimi në bazë të besimit fetar, ndërsa më së paku në klasën e shtatë (6%). Ky lloj i diskriminimit më së shpeshti ndodh në Kërçovë (21%).

Diskriminimi në bazë të prejardhjes sociale më së tepërmi ndodh në qytetin e Tetovës (27%), ndërsa më së paku në Kërçovë (17%). Më së shpeshti diskriminimi në këtë bazë ndodhën nga ana e bashkëmoshatarëve (84%), ndërsa më pas vijnë profesorët me (44%). Kjo çështje nuk ka dallim në lidhje me gjinitë e të anketuarve, por ka në lidhje me moshën. Në shkollën fillore përqindjet lëvizin prej 15% deri më 23%, ndërsa në shkollat e mesme prej 24,5% deri në 34,5%.

Sipas pyetjes për diskriminimin lidhur me prejardhjen etnike, 21% e të anketuarve personalisht kanë ndjerë asi lloji të diskriminimit, më së shumti nga ana e moshatarëve të tyre (77%), ndërsa 29% nga ana e profesorëve. Ky lloj i diskriminimit më së shpeshti ndodh në Tetovë, ndërsa më rrallë në Kavadar. Në bazë të prejardhjes etnike meshkujt ndihen më të diskriminuar (27%) përkundër vajzave me (16%). Ngjajshëm si edhe në bazë të prejardhjes sociale, ashtu edhe për atë etnike (përkatësia nacionale), diskriminimi në shkollat fillore lëviz prej 13% deri më 23%, ndërsa në shkollat e mesme prej 20% deri 33%.

Në shumë shkolla thyhet e drejta e edukimit për fëmijët me hendikep si rezultat i mosegzistimit të kushteve të përshtatshme për inkudrimin e tyre në mësimin e rregullt, që mes tjerash paraqet një formë të diskriminimit.

VI. Institucione, organizata dhe individë të cilët kujdesen për të drejtat e fëmijëve

Në anketën tonë, poashtu i pyetëm fëmijët cilat institucione dhe individë konsiderojnë se janë të obliguar që ti sigurojnë të drejtat e tyre. Në këtë pyetje i fituam rezultatet vijuese:

Institucione	Përqindje
Shteti	71%
Familja	38%
Shkolla	47%
Organizatat joqeveritare	20%

Mirëpo vetëm 21,5% nga fëmijët janë drejtuar diku kur u është shkelur ndonjë e drejtë e tyre, ndërsa 35% janë shprehur se deri më tani nuk u është thyer asnjë e drejtë e tyre.

Më së shumti besim fëmijët kanë në prindërit e saj të cilëve për ndihmë u janë drejtuar gjysma e tyre. Policisë i janë drejtuar 13,5%, ndërsa në ndonjërin nga SOS-telefonat vetëm 2%.

Si duket këta 2% janë të lidhur direkt me frigën e fëmijëve nga zbulimi i identitetit të tyre, e në veçanti për ata që jetojnë nëpër qytetet më të vogla.

E dhënë shtesë është se vetëm 6% nga fëmijët janë të njoftuar me ndonjë SOS numër të telefonit ku do të mundeshin të drejtohen për ndihmë nga tregtia me njerëz.

Më të njohura i kanë numrat e policisë, SOS-telefonin për fëmijë dhe të rinj “Megjashi” dhe SOS-linjën për tregti me njerëz.

Në kohë ku sa më shumë rritet numri i të varurve nga lëndët narkotike, e veçanërisht ndërmjet të rinjve, i tmerrshëm është fakti se një përqindje shumë e vogël janë të njoftuar se egzistojnë këshilltore për droga.

Vetëm 166 nga 2234 të anketuar i dijnë numrat e këshilltoreve për droga.

Nuk mund, e të mos përmendet se vetëm 2% e fëmijëve të cilëve u është thyer ndonjë e drejtë janë drejtuar në shkollë, ndërsa vetëm 0.3% në qendrën për punë sociale.

Edhe përkundër asaj se personat e autorizuar të punësuar nëpër këta institucione janë më kompetent sesa prindërit e tyre, prp fëmijët nuk kanë besim në ta.

Në një pjesë të shkollave nuk ka një komunikim mjaft të zhvilluar ndërmjet personave të autorizuar dhe fëmijëve.

Si shkak për mosparaqitjen e fëmijëve në Qendrën për punë sociale do të mund të përmendet edhe ajo se një pjesë e mirë e tyre si duket nuk janë të njoftuar me qendrat e këtilla dhe me punën e tyre.

15% e të anketuarve janë të kënaqur, ndërsa 2% nuk janë të kënaqur nga institucioni të cilit u janë drejtuar kur u është thyer ndonjë e drejtë.

Në pyetjen se “ A keni ndëgjuar për ambasadën e parë fëmijërore në botë - Megjashi?” pozitivisht janë përgjigjur 43%, nga të cilët vetëm 3% e dijnë se cili është roli i këtij institucioni.

Përafërsisht përqindje të njejta janë fituar edhe në pyetjen për atë se a kanë ndëgjuar fëmijët për Avokatin Popullor (45%) dhe cili është roli i tij (4,4%).

Çka ndërmarrin fëmijët për mbrojtjen e të drejtave të tyre?

Konsiderojmë se ne si fëmijë mundemi dhe duhet të kontribuojmë në mbrojtjen si të të drejtave tona ashtu edhe në mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve fëmijë. Mirëpo a e bëjnë këtë fëmijët?

Prej 66% deri 75% nga fëmijët i mbrojnë qëndrimet e tyre me qëllim që ti mbrojnë të drejtat e tyre në familje, shkollë dhe në rrugë. Mirëpo, nga 16% deri 18% nga fëmijët nuk guxojnë që të flasin dhe në atë mënyrë të kontribuojnë për mbrojtjen e të drejtave të fëmiut pa marr parasysh se për cilin mjedis bëhet fjalë.

Konsiderojmë se heshtja dhe tërheqja e fëmijëve ka të bëjë më karakterin e tyre, mënyrës së edukimit, presionit nga ana e prindërve, frigën që paraqitet te fëmijët dhe varësisht nga karakteristikat shoqërore dhe normat në mjedisin e tyre.

Përveç asaj se diku 73% nga fëmijët tregojnë interes për kyçje në aktivitete të cilat do të kishin kontribuar në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve (sikurse është “Kyçja e të gjithë fëmijëve në procesin edukativ”) prapë vetëm 29% e kanë pasur mundësinë që të kyçen në kësi lloj të aktiviteteve.

Konsiderojmë se kjo është e lidhur me aktivitetet e pakta si dhe mosinformimin e fëmijëve për egzistimin e tyre.

VII. Kualiteti i jetës

Për tu zhvilluar një fëmijë në një njeri aktiv dhe i suksesshëm, kualiteti i jetës ka ndikim shumë të madh. Duke e marrur parasysh këtë fakt, në anketën të cilën e realizuam, parashtruam disa pyetje qëllimi it ë cilave ishte që të kuptojmë se si fëmijët e vlerësojnë kualitetin e jetës së tyre.

Ishte e parashtruar pyetja ‘A fitojnë fëmijët informata të mjaftueshme për tema dhe ngjarrje të cilat janë nga lëmia e kulturës?’

Në këtë pyetje pozitivisht janë përgjigjur 69% për dallim prej 15% të cilët janë përgjigjur negativisht. Kjo përqindje tregon se pothuajse $\frac{3}{4}$ e fëmijëve janë të informuara për ngjarrjet kulturore në qytetin e tyre që është shumë pozitive.

Sidoqoftë, është e nevojshme një frekuentim më i madh i ngjarrjeve kulturore, si edhe organizim të ngjarrjeve kulturore, artistike konkretisht të orientuara ndaj popullatës së re.

Më pas ishte e parashtruar pyetja “ A fitojnë fëmijët personalisht informata nga lëmia e mbrojtjes shëndetësore?”.

Me përgjigjen PO janë shprehur 70% ndërsa me JO janë përgjigjur 13% e të anketuarve. Këtë pyetje pa u përgjigjur fare e kanë lënë 17% e të anketuarve. Në lidhje me gjininë u tregua se vajzat janë më tepër të informuara për këtë temë, përkatësisht 76% për dallim nga meshkujt me 68%.

Kjo është një përqindje e mirë e informimit, por konsiderojmë se gjendja mundet edhe më shumë të përmirësohet nëpërmjet të egzistimit të mjekëve shkollorë tek të cilët fëmijët do të mundën të drejtohen nëse u nevoitet ndihma mjeksore, kujdesi dhe këshilla. Ky propozim rrjedh nga ajo se shteti ka marrë për obligim që secilit fëmijë ti mundësojë qasje deri te shërbimet mjeksore - shëndetësore.

Nga lëmia e sportit (70.5%) nga fëmijët janë përgjigjur se fitojnë informata për çështje të cilat janë në interesin e tyre, ndërsa janë nga lëmia e sportit. Sidoqoftë, shumë fëmijë nuk sportojnë dhe nuk janë të kyçur në asnjëfarë aktiviteteve tjera nga lëmia e jetës sociale.

Rekomandimi ynë është që urgjentisht të ndryshohet qasja ndaj fëmijëve lidhur me sportin dhe aktivitetet sportive, me qëllim që ata të çojnë një jetë më aktive dhe më të shëndoshë.

Në pyetjen “A fitoni informata të mjaftueshme për çështjet të cilat janë në interesin tuend personal nga lëmia e të drejtave të njeriut?”, 65% nga të anketuarit janë përgjigjur me PO. Kjo është një e dhënë e cila nuk përshtatet me një informatë tjetër të

rëndësishme se pothuajse 73% nga fëmijët në pyetjen “Cilat të drejta të fëmijëve i ke të njohura?” nuk janë përgjigjur aspak.

Pse egziston kjo kontradiktë nuk mundet me siguri të vërtetohet, por duket se pjesa më e madhe e fëmijëve nuk janë të vetëdijshëm, përkatësisht nuk i njohin të drejtat e tyre.

Nga të gjitha këta pyetje erdhëm në përfundimin se fëmijët *më së paku fitojnë informata për çështjet të cilat janë në interesin e tyre ndërsa janë nga lëmia e edukimit seksual*. Vetëm 40% e fëmijëve janë përgjigjur pozitivisht në këtë pyetje.

Kjo na flet se fëmijët janë shumë pak të njoftuar me atë temë që paraqet një lëshim të madh sepse a më pak që është e zhvilluar ndërgjegjja tek fëmijët, aq më lehtë është që të keqtrajtohen ose shfrytëzohen për qëllime jot ë mira.

Mu për atë, konsiderojmë se në këtë pjesë shteti në të ardhmen patjetër do të duhet që të përkushtojë rëndësi më të madhe, nëpërmjet të vendosjes së edukatës seksuale në programet edukative.

Poashtu i pyetëm fëmijët se “A fitojnë informata të mjaftueshme për çështje nga lëmia e ndikimit të dëmshëm të nikotinit, alkoolit dhe drogës?”. Me PO janë përgjigjur 57% që don të thotë se pjesa tjetër e fëmijëve nuk janë të informuar.

Ndoshta përshkak të asaj të rinjtë përkatësisht fëmijët fillojnë me pirjen e duhanit, pirjen ose përdorimin e ndonjë droge që paraqet kanosje të madhe për shëndetin e tyre.

Rekomandimi ynë është që të egzistojnë debate të hapura në disa tema të këtilla si edhe kampanja me qëllim që të ngritet vetëdija tek fëmijët dhe të rinjtë.

VIII. Vërejtje të veçanta

Përveç të gjitha temave të përfshira në anketën tonë konsiderojmë se në një pjesë të vecantë duhet që të përmenden edhe këta si vijojnë:

Fëmijë të shkyçur(përrjashtuar) nga shkolla

BNë disa vitet e fundit u bënë reforma të rëndësishme në lëminë e arsimit. Përveç ligjit për arsim fillor të obligueshëm dhe Ligjit për arsim të mesëm të obligueshëm i përcjellur me kampanja të shumta. E gjith kjo rezulton me një numër më të madh të fëmijëve që deri më tani e kanë vazhduar shkollimin fillestar.

Mirëpo sipas të dhënave të fundit të Qeverisë (të shpallura në vitin 2005) në Maqedoni egzistojnë rreth 18 500 të cilat totalisht janë të përrjashtuar nga shkollat.

Bëhet fjalë për një numër mjaft të madh në të cilin ndikim më të madh kanë fëmijët romë. Më së shpeshti si shkak për atë është mosparaqitja në Librin amë të të lindurve menjëherë pas lindjes, me çka ata nuk e fitojnë të drejtën e identitetit.

Që të mundet të kyçen edhe këta fëmijë në procesin arsimor, është e nevojshme që shteti të gjejë mekanizma për gjetjen dhe evidentimin e fëmijëve të sapolindura dhe ta përshpejtojë procedurën për fitimin e identitetit të atyre fëmijëve të cilat nuk e kanë bërë me kohë atë.

Gjithashtu, konsiderojmë se duhet ë të angazhohen punëtorë social të cilët do të punojnë me prindërit e tyre.

Arsimimi kualitativ

Njëri nga problemet më të mëdha i cili paraqitet nëpër shkolla është niveli i ulët i cilësisë së arsimimit.

Planet mesimdhënëse në arsimin primar janë me përmbajtje të mëdha, joadekuate për moshën e fëmijëve dhe të mbushura me informata të tepërta. Një njësi mësimore zakonisht përmban prej 10- 20 fjalë të reja të panjohura. Dymbëdhjetë lëndë obligative në një klasë, të cilat gjatë javës përsëriten në orarë së paku dy herë, kërkojnë nga fëmijët në moshën 10-vjeçare mbajtjen mend e shumë të dhënave.

Orët plotësuese dhe këndet nëpër shkollat fillore shumë rrallë mbahen. Fëmijët shumë shpesh shkojnë nëpër shkolla private për gjuhë të huaja ose patjetër duhet që të marrin orë private nga matematika dhe lëndë të tjera, ndërsa prindërit e tanë e paguajnë çdo shërbim.

Edhe orët plotësuese të nevojshme për nxënësit me sukses më të dobët shumë rrallë mbahen dhe nuk paraqesin asnjëfarë praktike.

Në shkollat e mesme programet edukative janë të vjetruara, nuk ka mjete të mjaftueshme bashkëkohore për realizimin e mësimin (veçanërisht për shkollat me orientime profesionale), nuk ka angazhim maksimal dhe investim nga ana e profesorëve (mësimdhënësve), egziston korupsioni dhe mosinteresimi.

Kjo na tregon se neni 29 i Konventës për të drejtat e fëmijut nuk respektohet në tërësi dhe i vogël është numri i fëmijëve të cilët kanë mundësi që vetë të zhvillojnë afinitetet dhe talentet e tyre, por të rrallë janë edhe ata të cilët dijnë se cilët afinitete dhe talente i posedojnë.

Programi për **fëmijë të talentuar** në Maqedoni realizohet shumë rrallë. Organizata teknike popullore nuk punon me kapacitet të plotë. Garat nëpër disa lëndë dhe për klasat e caktuara janë shumë të rralla. Fëmijët nuk kanë forma për plotësimin dhe verifikimin e njohurive shtesë.

Ne mendojmë se shteti mund që ti zgjedhë problemet e lartpërmendura, vetëm duhet që të ndajë më tepër nga buxheti në arsim dhe të angazhojë inspekcione më të rrepta nëpër shkollat.

Fëmijë me nevoja të veçanta

Të gjitha shtetet anëtare të Konventës për të drejtat e fëmijut janë të obliguara që ti rrespektojnë dhe sigurojnë të drejtat e fëmijëve për secilin fëmijë pa asnjëfarë lloji të diskriminimit, po bile as edhe në diskriminimin e bazuar mbi paaftësinë.

Mirëpo edhe përkundër kësaj, shkollat në të cilat mësojnë 71% e të anketuarve nuk kanë qasje për fëmijët me hendikep me çka edhe e pamundësojnë inkuadrimin e tyre nëpër shkolla. Me atë ata ose do të fillojnë të rradhiten në fëmijët e shkyçura nga shkolla ose prindërit e tyre do të detyrohen për kyçjen e tyre në ndonjërin nga shkollat private. Çmimet për shkollimin e tyre nëpër shkolla private arrijnë prej 1000 deri më 5000 Euro për një vit shkollor, ndërsa të ardhurat mesatare në Republikën e Maqedonisë arrijnë deri më 350 Euro.

Konsiderojmë se kjo është një problem mjaft serioz për të cilin shteti ynë duhet që të gjejë zgjidhje në një kohë sa më të afërt.

Rrespektimi i të drejtave të fëmijëve

Në pyetjen : “Cilat të drejta nuk rrespektohen në familjen tënde?” 60% nga të anketuarit janë përgjigjur se ajo është e drejta e privatësisë, 32% e drejta e mendimit të tyre personal, ndërsa 7% janë përgjigjur se ajo është e drejta në arsimim.

Në anketimin tonë inkuadruam pyetje të lidhura me të drejtat e fëmijëve në shkollë. Në pyetjen : “A të ka ndodhur ty personalisht që profesori/profesoresha yte të mos i rrespektoje të drejtat tua?” 30% janë përgjigjur me “PO”, ndërsa 33% kanë refuzuar që të përgjigjen.

Në pyetjen: “A të ka ndodhur ndonjëherë ty personalisht që shokët e tu të mos i rrespektojnë të drejtat tua?” 28% janë përgjigjur pozitivisht, ndërsa rreth 32% e kanë lënë pyetjen pa ju përgjigjur, si duket për shkak se nuk kanë qenë të sigurtë se a u janë thyer të drejtat e tyre.

IX. Konkluzione

1. 1/3 e fëmijëve theksojnë se profesorët (mësuesit) nuk i rrespektojnë të drejtat e tyre. Ne konsiderojmë se ky është një problem i madh përshkak se fëmijët prej profesorëve mësojnë edhe nga ligjerimet e tyre, edhe nga veprimet e tyre në jetën e përditshme.
2. Të drejtat më pak të rrespektuara nëpër familjet janë e drejta e privatësisë (3/5) dhe e drejta në mendimin e tyre personal (1/3).
3. 1/5 e fëmijëve janë të vëna në rrezik nga dhuna familjare, ndërsa te 2,3% prej tyre kjo u ndodh gati se çdo ditë.
4. Gjysma e fëmijëve theksojnë se në shkollën e tyre ka dhunë. Nga to 14% janë shprehur se ajo ndodh për çdo ditë. Diku rreth 14,5% e të anketuarve profesorët (mësuesit) kanë ushtruar dhunë fizike mbi ta. Sipas nesh, dhunën fizike profesorët (mësuesit) e konsiderojnë si masë efikase pedagogjike dhe mu për atë edhe e përdorin dhe e llogarisin se e njejta mundet që të tolerohet.
5. Rreth 2/3 e fëmijëve janë përcaktuar se egziston dhunë nëpër rrugët, ndërsa 1/5 e tyre pohojnë se kjo ndodh për cdo ditë. 1/3 e të anketuarve kanë qenë personalisht të sulmuar. Nga këta të dhëna mund që të konkludohet se Siguria nëpër rrugë është në nivel mjaft të ulët.
6. Prej 1/5 deri 1/3 e fëmijëve janë shprehur se ata personalisht kanë kryer dhunë psikike ose fizike në familje, në shkolla dhe/ose në rrugë.
7. Prej 1/6 deri 1/3 e fëmijëve kanë refuzuar që të përgjigjen në pyetjen: “A kanë qenë të vënë në rrezik nga ndonjë lloj i dhunës?”. Shkakun për atë e shohim në frigen që haptazi të përgjigjen për kësi lloji të pyetjes.

8. Vetëm 21,5% e fëmijëve janë drejtuar diku kur u është cenuar ndonjë e drejtë e tyre, ndërsa besim më së shumti fëmijët kanë tek prindërit e tyre të cilëve për ndihmë u janë drejtuar rreth 50%.
9. Vetëm 6% e fëmijëve janë të njohur me ndonjë SOS numër telefoni ku do të kishin mundur që të drejtohen për ndihmë, ndërsa 1/3 e tyre janë drejtuar për ndonjë problem.
10. Vetëm 166 prej 2234 të anketuarve i dijnë numrat e këshillimoreve për drogë.
11. E drejta në barazi (pa diskriminim) është njëra ndër të drejtat më pak të njohura (2%). Fëmijët ndjehen të diskriminuar sipas më tepër kategorive edhe atë: moshë (44%), gjuha (19%), përkatësia etnike (17%), gjinia (16%), religjioni ose besimi fetar (15%) dhe raca (9%).
12. Më së shumti diskriminimi ndjehet në Tetovë, në bazë të gjuhës, përkatësisë etnike, gjinisë, religjionit, gjendjes sociale dhe racës, si edhe në qytetin e Kërçovës në bazë të moshës, përkatësisë etnike, religjionit dhe racës, por më së paku për shkak të gjendjes sociale.
13. Vajzat ndjehen më të diskriminuara nga meshkujt për shkak të moshës dhe gjinisë, ndërsa e kundërta vlen për gjuhen, përkatësia etnike, përkatësia fetare dhe raca.
14. Shikuar sipas moshës më së shumti diskriminim ka tek nxënësit nga klasa e pestë (në bazë të moshës dhe përkatësisë etnike), ndërsa më së paku në shkollat e mesme, viti i tretë. Ngjajshëm si në bazë të gjendjes sociale, ashtu edhe të prejardhjes etnike (përkatësia etnike), diskriminimi në shkollat fillore lëviz ndërmjet 13% dhe 23%, ndërsa në shkollat e mesme prej 20% deri 33%.
15. Fëmijët janë të diskriminuar më së shumti nga an e moshatarëve të tyre (77%), ndërsa më së paku ((29%) nga ana e profesorëve.
16. Në disa nga shkollat diskriminohen edhe fëmijët me hendikep, pasi që nuk egzistojnë kushte për inkudrimin e tyre në mësimin e rregullt, me çka thyhet e drejta e tyre në arsimim.

17. $\frac{3}{4}$ e fëmijëve nuk i njohin të drejtat e tyre, ndërsa nga të drejtat që i dijnë, më e njohur është e drejta e arsimimit në gjuhën amtare, ndërsa më pak e njohur është e drejta e barazisë (pa diskriminim).
18. $\frac{4}{5}$ konsiderojnë se të drejtat e fëmiut i inkuadrojnë edhe obligimet e tyre. Ata konsiderojnë se përgjegjësi është që ti kryejnë obligimet e tyre dhe të sillen me respekt ndaj të tjerëve.
19. Fëmijët kanë marrë informata për të drejtat e tyre duke ju faleminderuar shkollave, televizionit, shtëpisë dhe organizatave joqeveritare.
20. $\frac{1}{2}$ nga fëmijët kanë ndëgjuar për konventën për të drejtat e fëmiut nga të njejtat burime prej nga janë njoftuar edhe me të drejtat e tyre.

X. Rekomandimet tona

1. Shteti nëpërmjet institucioneve relevante patjetër duhet që të merr masa përkatëse me të cilat do ta garantojë sigurinë e fëmijëve në jetën e përditshme.
2. Promovim aktiv i arsimit për paqe dhe kyçjen në procesin e rregullt edukativ me qëllim të zvoglimit të shkallës së lartë të diskriminimit dhe dhunës ndërmjet moshatarëve.
3. Shteti të gjejë forma të mbështetjes mijërore/për të rinj (asociacione, shoqëri) nëpër shkollat dhe organizatat qytetare, ku do të promovohet dhe nxitet pjesëmarrja në procesin edukativ.
4. Sigurimin e kushteve profesionale dhe bashkëkohore për kuptimin e përmbajteve edukative në procesin arsimor.
5. Përmes kampanjave shtetërore dhe përmes medimeve fëmijët duhet të inkurajohen që ta paraqesin dhunën dhe çfardo lloji të dhunës ose thyerje e ndonjë të drejte.
6. Shteti të gjejë forma për informim masovik të të drejtave të fëmiut tek të gjitha kategoritë e qytetarëve (fëmijë, prind, kuadër arsimor dhe profesionistë nga të gjitha institucionet relevante).

7. Shteti të sjellë një ligj për shfrytëzimin e sigurtë të internetit nga ana e të miturve (kampanja për shfrytëzimin e sigurtë në shkolla dhe nëpërmjet të medimeve).
8. Në secilën shkollë të ketë mjek të përgjithshëm dhe dentist.
9. Shteti të gjejë mekanizma për shfrytëzimin e lypjes së fëmijëve nëpër rrugë si formë e sigurimit me mjete për jetesë.
10. Vendosjen e masave më të rrepta për mbrojtje nga përmbajtjet joadekuate për moshën dhe zhvillimin psikofizik të fëmijëve nëpër mediumet dhe shërbimet tjera informative.
11. Aplikim më të rreptë të Ligjit për ndalimin e shitjes së alkoolit dhe cigareve të të miturve, veçanërisht në qytetet më të vogla dhe ndalimin për shitje të çfarëdo lloji të materialeve pornografike nëpër vendet publike ku kanë qasje fëmijët.
12. Punë adekuate të shërbimeve profesionale në shkolla (pedagogët dhe psikologët) dhe zgjerimin e ekipeve me punëtorë social dhe defektolog.
13. Shteti duhet që të gjejë forma më adekuate me të cilat do ti njoftojë fëmijët për egzistimin, punën dhe rolin e qendrave sociale, SOS telefonat dhe Avokatin popullor ku do të mund të drejtohen për çfardo lloji të ndihmës.
14. Shteti duhet që të gjejë mekanizma për gjetjen dhe evidentimin e fëmijëve të sapolindura Romë dhe ta përshpejtojë procedurën për fitimin e identitetit të tyre për ata të cilët në kohën e duhur nuk e kanë bërë atë që të mundet që edhe këta fëmijë të kyçen në procesin edukativo-arsimor.

XI. Rekomandime nga fëmijë të tjerë

ARSIMI

*Aplikimin e Ligjit për arsimin e mesëm obligues tek nxënësit e përkatësisë etnike shqiptare.

*Vendosjen e Këshillit të fëmijëve në shkollat fillore dhe të mesme nëpërmjet të cilëve nxënësit do të mund që ti shprehin nevojat e tyre dhe të komunikojnë me arsimtarët.

*Ditë të hapura për shoqërim të fëmijëve, prindërve dhe arsimtarëve.

- *Organizimin e ekskurzioneve disa ditëshe jashta shtetit për fitimin e njohurive dhe përvojave të reja të fëmijëve.
- *Aplikimin e materialit vizuel nëpër shkolla me çka do të thyhet monotonija dhe do të arrijnë sukses më të madh nga ana e nxënësve.
- *Orët të zgjasin më shkurtë se 30 minuta.
- *Pajisje më bashkëkohore nëpër shkolla duke i llogaritur këtu edhe televizorët, klimë, DVD.
- *Të vendoset praktika në arsim me kabinete të mira të pajisura dhe kabinete ku fëmijët do të fitojnë njohuri të përhershme.
- *Me Ligjin në të cilin thuhet “Libra falas për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme” të mos jenë të përjashtuar nxënësit nga ana e shkollave me drejtim profesional, pasi që me atë bëhet diskriminim ndaj të njejtave me realizimin jot ë plotë të atij ligji.
- *Të zvoglohet fondi i orëve dhe të largohen lëndët e panevojshme, përkatësisht të jepet liri nxënësit të zgjedhin se çka dëshirojnë të mësojnë.
- *Të sigurohen kushte më të mira ku do të realizohet procesi edukativ, përkatësisht për personat me nevoja të posatshme.
- *Mësim në 5 lëndë varësisht nga shkollimi i mëtejshëm i fëmiut.
- *Pemë për secilin nxënës gjatë pushimeve në shkollë.
- *Orë plotësuese për shoqërim dhe debatim të fëmijëve në temën “të drejtat e fëmijëve”.
- *Ndjekjen e mësimin nëpërmjet të kompjuterit dhe internetit.
- *Gjatë mbarimit të vitit shkollor, libër për secilin nxënës me sjellje shembullore.
- *E drejta e ushqimit të shëndetshëm në shkollë - pushime më të gjata, ndalimin e pijeve të gazuara, ndalimin e FAST FOOD ushqimeve, dhënien e pemëve dhe perimeve që nuk i shkatërron fëmijët.
- *Të mos i mësojmë të shtunat që i zavendësojmë për ditën e mbjelljes së drunjtve.
- *Vendosja e rrjetit të bashkëpunimit me vendet e jashtme me çka do të mundësohet realizimi i këmbimit ndërmjet nxënësve me qëllim që të barten eksperiencat edukative nga njëri në vendin tjetër.
- *Kushte më të mira për shkollim në vendet rurale.

*Secila shkollë të ketë sigurim që fëmijët të jenë më të sigurtë gjatë kohës së mësimi (Kërçovë).

SHËNDETËSIA

*Departament shëndetësor i vendosur në secilën shkollë.

DISKRIMINIMI

*Vendosjen e materialit vizuel në shkolla me çka do të thyhet monotonia dhe do të arrihet sukses më i madh nga ana e nxënësve.

*Organizimin e trajnimeve për profesorët në temën “ Të gjithë fëmijët janë të barabartë”, me qëllim që të ndalen ndarjet e tyre, të cilat më së shpeshti janë të bazuara ndihmën financiale dhe autoritetit të prindërve të fëmijëve.

*Organizimin e më tepër aktiviteteve (tribuna, debate, seminare, aktivitete sportive) ku do të shoqërohen fëmijë nga kombësitë e ndryshme.

EDUKIM

*Mbajtja e tribunave dhe debateve lokale ku vetë fëmijët do ti kishin prezentuar mendimet personale të tyre në lidhje me problemet e përditshme që na rrethojnë.

*Edukimin e të gjithë qytetarëve për të drejtat e fëmijëve dhe rëndësinë që ata kanë me qëllim që të sigurohet një ambient më i mirë për zhvillimin e fëmijëve.

MEDIUMET

*Të zvoglohen programet e dhunshme, lajme dhe filmat në TV.

TË TJERA

*Në qytetin tonë (Kërçovë) fëmijët nuk kanë asnjë vend për rekreim dhe për luajtje. нашиот град (Кичево) децата немаат ниту едно место за рекреација и за играње.

*dëshirojmë që të renovohen parqet fëmijërore.

*Vënien e ligjit për mbrojtje nga detyrimi i të miturve Romë për lypje dhe lirim nga shkollat për shkak të kryerjes së punëve shtëpiake dhe aktiviteteve të parëndësishme nga ana e kujdestarëve të tyre.

*Të egzistojnë sanksione për secilin të rritur i cili nuk ju lejon fëmijëve që të luajnë dhe ua shpon topin;

*Tu mundësohet fëmijëve që ta shprehin kreativitetin e tyre.

*Të vihet më lehtë deri te informatat të cilët i interesojnë të rinjtë.

*Duam Evropën nën emrin tonë kushtetues.

*Ligje më të rrepta në lidhje me shitjen e duhanit dhe alkoolit si edhe përcaktimin e kufirit të kohës për dalje jashtë të fëmijëve nën 18 vite.